

### Ç'të behet për vizat?

Pasi që studentët të kenë pranuar vërtetimin zyrtar që janë pranuar në Programin e masterit Erasmus Mundus, **ata doemos duhet të marrin vizë, në mënyrë që të studiojnë në Europë.** Për informata mbi kërkesat për vizë, atyre u këshillohet që të kontaktojnë me delegacionet e KE-së në vendet partnere në UE si dhe me Konsullatet dhe Ambasadat e shteteve anëtare të UE-së në vendet në fjalë, sapo të kenë pranuar konfirmimin zyrtar që janë selektuar.

Kursi i Masterit Erasmus Mundus iu ofron studentëve këshilla dhe dokumente mbështetëse, të cilat shpesh lehtësojnë procesin. Megjithatë, studentët inkurajohen që të kërkojnë vizat sa më parë.

*Mos harro: Marrëveshjet e lehtësimit të vizave midis UE-së dhe Shqipërisë, Bosnjë e Hercegovinës, ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë, Malit të Zi dhe Serbisë hynë në fuqi më 1 janar 2008. Kjo duhet të lehtësojë dhënien e vizave afatshkurtëra për studentët e këtyre vendeve me një vlerë të zvogëluar prej 35 euro për çdo aplikim.*

### Mundësi të tjera për bursa

Shtetet anëtare të UE-së dhe vendet e tjera të Europës kanë programet e veta bilaterale të bursave për studentët nga vendet e Ballkanit Perëndimor. Mos hezitoni të interesoheni drejtpërsëdrejti në vendet të cilat juve ju interesojnë.

### Ku mund të studioni?

Mund të studioni në cilindo qoftë vend të Unionit European, Kroaci, Turqi, Islandë, Lihtenshtajn ose Norvegji, varësisht nga partneriteti i përzgjedhur.

Një partneritet duhet të përbëhet nga 5 universitete europiane dhe secili nga ata duhet të jetë i anëtarësuar në marrëveshjen Erasmus; nga 3 vende të Unionit European plus një ose më tepër universitete nga së paku 3 vende të ndryshme nga rajoni i Ballkanit Perëndimor.

### Afati i aplikimeve individuale

Studentët, hulumtuesit dhe stafi akademik mund të aplikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë për partneritetet e përzgjedhura për grante mobiliteti. Informatat mbi partneritetet e selektuara mund të shkarkohen nga faqja në vijim:

[http://eacea.ec.europa.eu/index\\_en.php](http://eacea.ec.europa.eu/index_en.php)

[http://eacea.ec.europa.eu/erasmus\\_mundus/results\\_compendia/selected\\_projects\\_action\\_2\\_en.php](http://eacea.ec.europa.eu/erasmus_mundus/results_compendia/selected_projects_action_2_en.php)

### ERASMUS MUNDUS AKTIVITETI 2

Kush mund të përfitojë?	Kohëzgjatja e qëndrimit (studime me orar të plotë)	Lloji i shkëmbimit	Lloji i bursës që ofrohet?
Studentët dhe stafi akademik të regjistruar në një nga universitetet anëtare të partneritetit të përzgjedhur që janë: Shtetas të Shqipërisë, Bosnjë e Hercegovinës, ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë, Malit të Zi dhe Serbisë, si dhe Kosovës	6-10 muaj > 6-22 muaj > 6-34 muaj > 6-10 muaj > 1-3 muaj >	Studime universitare Studime master Doktorat Hulumtim pas-doktorature Staf akademik	Bursa mbulon: <ul style="list-style-type: none"><li>udhëtimin (nga 250€ deri në 2500€, varësisht nga distanca);</li><li>shpenzimet e sigurimit (75€ në muaj për sigurim shëndetësor, udhëtim dhe aksident);</li><li>shpenzimet e shkollimit (nëse shkëmbimi zgjat më pak se 10 muaj nuk ka shpenzime, kurse në rastet e tjera, maksimum 3000€ për një vit akademik)</li><li>mëditjet (nga 1000€ deri 1800€, varësisht nga statusi: studime universitare, studime masteri, doktoratura ose pas-doktoratura dhe 2500 € për personelin mësimdhënës)</li></ul>
Shtetasit e Shqipërisë, Bosnjë e Hercegovinës, ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë, Malit të Zi dhe Serbisë, si dhe Kosovës të regjistruar në institucione të larta arsimit, në vendet që nuk janë përfshirë në partneritet ose me diplomë universiteti apo ekuivalent të diplomës së tillë nga ndonjë institucion i këtyre vendeve	6-22 muaj > 6-34 muaj > 6-10 muaj >	Studime master Doktoraturë Pas-doktoraturë	Bursa mbulon: <ul style="list-style-type: none"><li>shpenzimet e udhëtimit (nga 250€ deri 2500€, varësisht nga distanca);</li><li>shpenzimet e sigurimit (75€ në muaj)</li><li>shkollimi (maksimum 3000€ për një vit akademik, 5000€ për studime specializimi)</li><li>mëditjet (nga 1000€ deri 1800€ varësisht nga statusi: master, doktoraturë ose specializim),</li></ul>

Kjo skemë operon në të gjitha disiplinat akademike, edhe pse prioritet mund t'i jepet shkencave të bujqësisë, arkitekturës dhe planifikimit rajonal, studimeve të biznesit, in-

hinerisë dhe teknologjive, gjuhëve dhe shkencave filologjike, drejtësisë, matematikës dhe informatikës, shkencat e mjekësisë, shkencat natyrore, shkencat sociale.



## Studimi në Europe

Bursat e Ue-Së për Studentët e Ballkanit Perëndimor



Qindra bursa janë tani në dispozicion për studentët e vendeve të Ballkanit Perëndimor, për vitin akademik 2008/2009 dhe më tutje.

**Programi ERASMUS MUNDUS** ofron mbështetje për studime pas universitare (programe të masterit në UE) për 150 studentë nga vendet e Ballkanit Perëndimor, në universitetet e vendeve të UE-së.

*Programet e Masterit Erasmus Mundus janë programe të kualitetit të lartë në nivelin e masterit, pothuajse në të gjitha degët akademike.*

Për më tepër **programi ERASMUS MUNDUS AKTIVITETI 2** ofron ndihmë financiare në formë të 600 granteve të mobilitetit për studentë, hulumtues dhe personel akademik.

#### Ku mund të studioni?

Një konsorcium i institucioneve të arsimit të lartë nga vendet anëtare të UE-së, Islanda, Lihtenshtajni, Norvegjia dhe vendet candidate (Kroacia, Turqia, ish Republika Jugosllave e Maqedonisë) marrin pjesë në Programin e Masterit Erasmus Mundus. Studentët doemos duhet të kalojnë një periudhë të studimeve, së paku në dy nga shtetet e vendeve të përfaqësuara nga ky konsorcium.



### PROGRAMI ERASMUS MUNDUS

Lloji i bursës	Kush përfiton?	Kohëzgjatja e qëndrimit (studime me orar të plotë)	Vlera e bursës
Në nivel pasuniversitar	<b>Personat me kualifikim të lartë</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>që kanë diplomë nga institucioni i lartë arsimor</li> <li>që janë pranuar në Studimet e Masterit Erasmus Mundus</li> </ul>	Minimum 1 vjet	21000 €
	<b>Shtetasit e</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>Shqipërisë,</li> <li>Bosnjë e Hercegovinës,</li> <li>Kroacisë,</li> <li>Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë,</li> <li>Malit të Zi,</li> <li>Serbisë, si dhe Kosovës, në suaza të rezolutës së Këshillit të Sigurimit të KB-së 1244/99</li> <li>Turqisë (për vitin akademik 2009/2010)</li> </ul>	Maksimum 2 vjet > 1 dhe < 2 vjet	42000 € % midis 21 000 dhe 42 000 € Bursa mbulon shpenzimet e udhëtimit, kostot e jetesës, shkollimin, si dhe sigurimin për sëmundje dhe aksidente
Për mësimdhënie dhe detyra hulumtimi	<b>Akademikët ose profesionistët që janë shtetas nga</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>Shqipëria</li> <li>Bosnjë e Hercegovina</li> <li>Mali Zi</li> <li>Serbia si dhe Kosova</li> </ul>	3 muaj	Maksimum 13000 €

#### Si të aplikoni për bursë?

Studentët duhet të **aplikojnë drejtpërsëdrejti** në konsorciumet e Masterit Erasmus Mundus, të cilat ofrojnë programet e zgjedhjes së vet. (Shiko listën e Programeve të Masterit Erasmus Mundus në faqen Europa)

Edhe pse kandidatët mund të aplikojnë në cilindo nga programet e përzgjedhura të Masterit në kuadër të programit Erasmus Mundus, numri i aplikimeve duhet të jetë i kufizuar në më së shumti tre Programe Masteri Erasmus Mundus.

Konsorciumi i informon studentët e interesuar mbi kushtet e veçanta të regjistrimit (p.sh. rezultatet e studimeve, shkathtësitë gjuhësore, etj.) dhe afatet e aplikimit.

Çdo program studimi ka kushte të veçanta të aplikimit dhe regjistrimit, formularë të aplikimit dhe afate.

Konsorciumi që ofron Programin e studimit, vendos se cilët studentë do t'i pranojë dhe cilëve studentë t'u japë bursa sipas meritës dhe me mekanizma transparente të përzgjedhjes.

#### Afati i dorëzimit të aplikimeve individuale

Studentët dhe hulumtuesit duhet t'i dorëzojnë aplikimet e tyre **para afatit të caktuar nga konsorciumi i studimeve të Masterit Erasmus Mundus, zakonisht në dhjetor ose janar të çdo viti.**

**Informata më të hollësishme mbi programin mund të gjeni në faqen e Erasmus Mundus:**  
[http://ec.europa.eu/education/programmes/mundus/index\\_en.html](http://ec.europa.eu/education/programmes/mundus/index_en.html)

[http://eacea.ec.europa.eu/erasmus\\_mundus/results\\_compendia/selected\\_projects\\_action\\_1\\_master\\_courses\\_en.php](http://eacea.ec.europa.eu/erasmus_mundus/results_compendia/selected_projects_action_1_master_courses_en.php)